



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 01.09.2016

Vendim
Nr. 30, datë 01.09.2016

PËR DIGJITALIZIMIN E INFORMACIONIT TË BRENDSHËM
UNIVERSITAR DHE ADMINISTRATIV TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Mbështetur në nenin **37**, pika **1**, nenin **38**, pika **1** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit **36** dhe **37** të Ligjit Nr. 9154, datë 06. 11. 2003, "Për Arkivat", Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 01.09.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procesit për digjitalizimin e informacionit të brendshëm universitar të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, që nënkupton instalimin e sistemit informatik në funksion të procedurave akademike dhe administrative të studentëve, pedagogëve dhe administratës, sistem i cili të përfshijë edhe shërbimin digjital për përzgjedhjen e kandidatëve të maturës shtetërore që do të aplikojnë në programet e studimit që ofron Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë përmes marrëveshjeve të përvitshme.
2. Ky proces të kryhet në marrëveshje me Rrjetin Akademik Shqiptar (Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjeti Telematik), agjenci në partneritet me MAS.
3. Sistemi informatik i instaluar për të gjitha veprimet dhe të dhënat e brendshme universitare të ketë vlerë arkivore, juridike dhe administrative si Dokument i Numerizuar duke iu përshtatur legjislacionit të kësaj fushe.
4. Specifikimet teknike të programeve të instaluara për këtë qëllim të pasqyrohen në rregulloret e brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të të gjitha niveleve.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5. Autorizohet Rektori për nënshkrimin e marrëveshjeve me entin e sipërpërmendur.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Drejtoria e financave, Drejtoria e IT, Zyra juridike, dekanët dhe përgjegjësit e njësive bazë, sekretariatë mësimore dhe kryesekretaritë e fakulteteve.
7. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.